

VENDIM
Nr. 665, datë 24.10.2024

PËR ZBATIMIN E PASOJAVE TË SHFUQIZIMIT TË LIGJIT NR. 13/2016, “PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SPORTELE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 14 e 15, të ligjit nr. 100/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, e të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbyllja e ADISA-s, si pasojë e shfuqizimit të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, shoqërohet me kryerjen e të gjitha procedurave për zgjidhjen e kontratave të punës të punonjësve të saj, sipas parashikimeve të nenit 14, të ligjit nr. 100/2014, si dhe të dispozitave të Kodit të Punës.

2. ADISA të kryejë procedurat në funksion të përfundimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve të saj, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës, duke u paguar atyre të gjitha detyrimet e parashikuara nga dispozitat e tij për punonjësit në rrethanat përkatëse, sipas rastit.

3. Pasuritë e paluajtshme, aktualisht në përgjegjësi administrimi të ADISA-s, së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera që lidhen me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si më poshtë vijon:

a) pasuria me nr. 6/6-ND2/1, vol. 34, fq. 17, në zonën kadastrale 8531, (prona me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, mjediset e katit përdhes Fier);

b) pasuria me nr. 3/703, në zonën kadastrale 8621 (lagjia nr. 1, Krujë);

c) pasuria me nr. 25/2, në zonën kadastrale 8525 (prona me emërtimin “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendndodhje në lagjen “5 Maji”, Elbasan);

ç) pasuria me nr. 16/51-1, në zonën kadastrale 8571, dhe pasuria 16/51-2, në zonën kadastrale 8571 (lagjia “Kongresi” Lushnjë);

d) mjediset e katit të parë, me sipërfaqe 412 (katërqind e dymbëdhjetë) m², të ndërtesës me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Gjirokastër, pjesë e pasurisë me nr. 24/15, zona kadastrale 8541.

4. Sendet e luajtshme në administrim të ADISA-s i kalojnë në administrim AKSHI-t, me përjashtim të:

a) sendeve të luajtshme që gjenden në katet e pestë dhe të gjashtë të godinës, e cila identifikohet në bazë të pikës 9, të këtij vendimi. Këto sende i kalojnë përkatësisht Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);

b) 2 (dy) automjeteve “Toyota”, me targa AA 043 PL dhe AA 046 PL, të cilat do të kalojnë në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC);

c) 2 (dy) automjeteve: *SKODA Yeti* me targa (AA 539 NN) dhe furgoni me targa (AA 953 XM), të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP).

Për këtë qëllim, ADISA përgatit inventarët e sendeve të luajtshme, si dhe kryen të gjitha procedurat, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Institucioneve përkatëse u kalojnë edhe të gjitha të drejtat e detyrimet që lidhen me këto sende, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Drejtori i Përgjithshëm i ADISA-s njofton Kryeministrin për përfundimin e të gjitha procedurave të parashikuara në këtë vendim. Pas marrjes së këtij njoftimi, Kryeministri miraton

urdhrrin për lirimin nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të ADISA-s, i cili përbën çastin e mbylljes së ADISA-s. Kryeministria përcjell për botim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare njoftimin për mbylljen e ADISA-s, pas miratimit të këtij urdhri.

6. Dokumentacioni arkivor dorëzohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat.

7. Efekti financiar, sipas këtij vendimi, përballohet nga fondet e parashikuara për ADISA-n në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”, të ndryshuar. Fondet e mbetura të papërdorura rikthehen në buxhetin e shtetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

8. Për ambientet, që ADISA-s i janë dhënë më parë në përdorim nga bashkitë, AKSHI mund të bashkërendojë me këto bashki, në funksion të marrjes në përdorim, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, të atyre ambienteve që janë të nevojshme për ecurinë e veprimtarisë së saj, nëse ka dakordësi nga bashkitë përkatëse.

9. Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pika 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kati i pestë dhe i gjashtë i godinës, sipas planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, u jepen në përdorim të përkohshëm, përkatësisht, Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për sistemimin e administratave të tyre.”.

10. Ngarkohen Kryeministria, ADISA, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku